

Hapet thirrja për bursa studimi për studentët e UMT, në Universitetin CY TECH në Francë, në kuadër të programit Erasmus +.

Mobiliteti dhe kohëzgjatja e bursave:

Studentët do të studiojnë semestrin e parë të vitit akademik 2025-2026 në universitetin CY TECH, Francë.

Kush mund të aplikojë:

Mund të aplikojnë studentët e UMT të cilët gjatë vitit akademik 2025-2026 do të jenë në vitin e dytë dhe të tretë, të ciklit bachelor si edhe studentët e vitit të parë dhe të dytë master, në:

- Fakultetin e Inxhinierisë dhe Arkitekturës
(Mund të aplikojnë studentët nga dega e Inxhinierisë së Ndërtimit)
- Fakultetin e Shkencave Kompjuterike dhe IT
- Fakultetin e Ekonomisë
(Mund të aplikojnë studentët Master në Business Analytics and Artificial Intelligence)

Duhet të kontaktoni Zyrën e Marrëdhënieve me Jashtë për tu pajisur me lëndët të cilat do të zhvillohen në anglisht në universitetin pritës në semestrin i dytë .

Gjuha e mësimdhënies:

Mësimdhënia do të jetë në gjuhën angleze.

Bursat përfshijnë:

- Kompensimin mujor për studentët (850 EUR në muaj);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të originës).

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni në këtë link:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kopje e pasaportës
- Listë notash të ciklit aktual të studimit;
- Fotokopje e Certifikatës/dëshmi e gjuhës angleze ose dokument që vërteton njohuritë në këtë gjuhë. Niveli i kërkuar B2; Kur mungon certifikata e njohur ndërkombëtarisht atëherë pajisuni me një certifikatë nga lektori i gjuhës angleze në UMT.
- Learning Agreement*

** Learning Agreement është një kontratë midis universiteti të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Before the mobility." Në tabelën përcaktohen lëndet dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihen në Universitetin Metropolitan Tirana kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.*

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin CY TECH Paris, Francë lëndë të njëjta me ato që do të kryenit në semestrin e parë vitit akademik 2025/2026 në fakultetin tuaj, kjo në mënyrë që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj, atëherë kur të ktheheni duhet të jepni provim lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Metropolitan Tirana.

Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti dhe më pas në seksionin "sending university" firmoset nga Përgjegjësi i Departamentit në UMT.

Afati për aplikim: **31 Mars, 2025**

Për të aplikuar, ju lutemi kontaktoni me e-mail në adresën iro-projects@umt.edu.al të Zyrës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Universitetit Metropolitan Tiranë.

UMT ju uron shumë suksese në aplikimin tuaj!